



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201402255/4

Tiranë ___/___/2014

Lënda: Rekomandohet *"Përmirësimi i punës me qëllim zbatimin korrekt nga Prokuroria të dispozitave procedurale, për dhënien e kopjeve të akteve, shqyrtimin e vlerësimit e kërkesave apo memorieve me shkrim, si dhe njoftimit menjëherë të vendimeve përfundimtare, palëve në procesin penal"*.

Drejtuar: Prokurorit të Përgjithshëm
Z. Adriatik LLALLA

TIRANË

I nderuar Z. Prokuror i Përgjithshëm,

Në praktikën e punës gjatë trajtimit të kërkesë/ankesave të qytetarëve drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, kemi konstatuar se ata duke qënë palë në procesin penal, në raste të caktuara i janë drejtuar me kërkesë apo memorie me shkrim organit procedues, me qëllim marrjen e kopjeve të akteve të veçanta ose kryerjen e veprimeve të ndryshme gjatë hetimit të procedimit penal. Gjatë trajtimit të ankesave është vënë re se, jo në pak raste nga ana e Prokurorëve të çështjes, nuk janë vënë në dispozicion kopje të akteve të kërkuara apo nuk janë shqyrtuar dhe vlerësuar kërkesat e palëve, dhe për rrjedhojë prej tyre nuk janë respektuar dispozitat procedurale të parashikuara në nenet 105 dhe 110 të Kodit të Procedurës Penale. Në raste të tjera Prokuroria nuk ka njoftuar menjëherë palët për vendimin e marrë, çka bie ndesh me nenin 291/2 të Kodit të Procedurës Penale etj.

Problematikat e rasteve kanë konsistuar :

Së pari: Në mosdhënien e akteve të ndryshme (në disa raste origjinale), të sekuestuara gjatë hetimit të procedimeve penale.

Në ankesën me nr.201401173, qytetari G. Gj., nga Tirana, është ankuar seduke qënë pronar me dokumente të rregullta i dy automjeteve me targa TR.4362-B dhe TR.2032-L, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në funksion të procedimit penal nr.928 të vitit 2005, i ka sekuestruar dhe dokumentet përkatëse të këtyre mjeteve. Pas kryerjes së veprimeve hetimore, hetimet e procedimit penal janë pezulluar në dy raste dhe konkretisht në datat 15.06.2005 dhe datë 01.10.2010. Megjithë kërkesat e qytetarit G. Gj., për të dërguar dokumentet origjinale të mjeteve pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë, përsëri edhe pse kishin kaluar 9 vjet nga koha e sekuestrimit të tyre, si nga Prokuroria ashtu dhe Policia nuk ishin marrë masat e nevojshme për realizimin e saj.

Mbi këtë shqetësim të qytetarit G.Gj., nga ana e jonë, janë kryer disa veprime verifikuese si dhe dërguar shkresa si Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë ashtu dhe Drejtorisë së Policisë të Qarkut Tiranë, pasi prej tyre kishte përgjigje retorike duke hedhur përgjegjësinë sa nga njëri tek tjetri institucion. Të ndodhur në këto rrethana, për të vënë në vënd të drejtën e shkelur qytetarit G. Gj., më datën 30.07.2014, me shkresën nr.K2/G27-7, i kemi Rekomanduar drejtuesve të Prokurorisë dhe Policisë Tiranë, *“Marrjen e masave të menjëhershme, me qëllim dërgimin e akteve të dosjes origjinale të automjeteve në pronësi të shtetasit G. Gj., pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë”*.

Pas shumë zvarritjesh, vetëm më datën 09.10.2014 është bërë i mundur realizimi i Rekomandimit tonë, pasi Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në këtë datë me shkresën nr.11305/1, informon Institucionin e Avokatit të Popullit se dosjet origjinale të mjeteve në pronësi të shtetasit G. Gj., i janë dërguar DRSHTRR Tiranë.

Rasti i ankesës me nr.201401137, i qytetarit H. Ç., nga Tirana, i cili ka kërkuar ndërhyrjen e Institucionit të Avokatit të Popullit, pasi megjithë kërkesave të tij të përsëritura, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk i ka vënë në dispozicion kopje të akteve të procedimit penal nr. 397 të vitit 2014, në ngarkim të shtetasve A. D., etj.

Mbi këtë shqetësim, më datën 11.06.2014, me shkresën nr.K2/H9-3 i kemi kërkuar informacion Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke vendosur dhe një afat për kthimin e përgjigjes. Pa respektuar afatin e kërkuar, pasi kishin kaluar mbi dy muaj nga kërkesa e jonë, më datën 05.09.2014, me shkresën nr. K2/H45-6 kemi përsëritur kërkesën drejtuar Prokurorisë. I njëjti qëndrim ka vazhduar edhe pas kalimit të afatit të shkresës së dytë dhe të ndodhur në këto rrethana, më datën 10.11.2014, me shkresën nr.K2/H9-7, kemi Rekomanduar ndërhyrjen Tuaj, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për kthimin e përgjigjes të shkresave tona. Pas Rekomandimit, ka qënë i menjëhershëm reagimi Juaj, pasi më datën 18.11.2014, me shkresën nr.136/4, i keni dërguar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Rekomandimin duke i kërkuar kthimin e përgjigjes në një kohë sa më të shkurtër Institucionit të Avokatit të Popullit. Le për të dëshiruar qëndrimi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi ende nuk ka dërguar përgjigjen mbi qëndrimin e saj ndaj Rekomandimit.

Rasti me nr.201203713, për ankesën e shtetasit V. Q., nga Tirana, i cili ka ngritur shqetësimin se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, megjithë kërkesat

e tij, nuk i ka vënë në dispozicion aktet e procedimit penal nr.1323 të vitit 2011, sidomos aktin e ekspertimit teknik grafik të shkrimit.

Edhe për këtë rast, megjithë kërkesat tona të vazhdueshme për dhënien e kopjeve të akteve qytetarit, jemi ndeshur jo vetëm në vonesa në kthimin e përgjigjeve të shkresave tona, por dhe në moszgjidhjen e faktit të ndodhjes së fashikullit të hetimit, në Prokurori apo Polici, pasi fashikulli i hetimit pas pezullimit ishte dërguar në Drejtorinë e Policisë së Qarkut, por sipas Policisë dosja ishte përcjellë përsëri Prokurorisë.

Siç jeni në dijeni, për zgjidhjen sa më parë të ankesës së qytetarit V. Q., më datën 21.10.2014, me shkresën nr.K2/V46-19, kemi kërkuar përsëri ndërhyrjen Tuaj me qëllim zbatimin e Rekomandimit. Edhe në këtë rast reagimi i Prokurorisë së Përgjithshme ka qënë i menjëhershëm dhe për Rekomandimin tonë është vënë në dijeni Prokuroria e Rrethit Gjirokastrë, e cila ka realizuar kërkesën e shtetasit V.Q., duke i vënë në dispozicion aktet e kërkuara.

Në ankesën me nr. 201203664, qytetari Xh. Ç., nga Vlora, ankohet ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjirokastrë, për arsye se sipas tij nuk i ka dërguar ZVRPP Vlorë, aktet origjinale të pronësisë, të sekuestruara në procedimin penal nr.189, filluar prej saj në vitin 2005. Ankesa e qytetarit Xh. Ç., është trajtuar në vitin 2012, dhe nga ana e jonë më datën 18.12.2012, sipas shkresës nr.K2/Xh33-5 i kemi dërguar Rekomandim Prokurorisë së Rrethit Gjirokastrë Vlorë, për marrjen e masave me qëllim dërgimin e dokumenteve, ZVRPP Vlorë.

Në përgjigje të Rekomandimit tonë, Prokuroria e Rrethit Gjirokastrë Vlorë, me shkresën nr.1145/1 datë 13.02.2013, (bshkëlidhur kopje e shkresës) informon ndërmjet të tjerave Institucionin e Avokatit të Popullit se: *"...Përsa i përket vonesës së zgjidhjes së ankesave të përsëritura të qytetarit (shkresave të dërguara nga ana e juaj) ju bëjmë me dije se megjithë preokupimet dhe angazhimin maksimal tonin, nuk ishte bërë e mundur të gjëndeje dosja e pushuar në arkivin e institucionit, pasi në vendimin e pushimit të Prokurorit ishte referuar procedimi penal nr.1314 e vitit 2009, dhe gjithë arsyetimi e përfundimi i referohej materialit kallëzues. Ky fakt solli vonesën në gjetjen e dosjeve në arkiv (pasi na u dhash të kthenim të gjitha materialet e arkivuara). Ndodhur para këtij fakti do të procedohet duke u kthyer praktikat e sekuestruara pranë ZVRPP Vlorë".*

Mbi këtë bazë, kemi njohur ankuesin Xh. Ç., me përmbajtjen e përgjigjes së Prokurorisë Vlorë duke e sqaruar për faktin se ishte e drejta për t'u interesuar në atë Institucion.

Qytetari Xh. Ç., më datën 01.12.2014, është drejtuar me një kërkesë duke vënë në dijeni Avokatin e Popullit, për faktin se ankesa e tij nuk ka marrë zgjidhje, pasi është interesuar në ZVRPP Vlorë, ku e kanë sqaruar se aktet e pronësisë nuk ishin dërguar nga Prokuroria. Mbi këtë shqetësim, menjëherë kemi kërkuar ndërhyrjen e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjirokastrë Vlorë, për zbatimin e Rekomandimit tonë dhe jemi në pritje të përgjigjes, duke shpresuar në zgjidhjen sa më shpejt të ankesës së qytetarit Xh. Ç.

Ankesa me nr.20140225, e qytetarit V. D., nga Tirana, i cili ka ngritur pretendimin se Prokuroria e Rrethit Gjirokastrë Tiranë nuk i ka vënë në dispozicion kopje të aktit të detyrimit për marrjen e një kredie, për të cilën

Prokuroria pas kallëzimit penal, më datën 07.06.2004, kishte vendosur mosfillimin e procedimit penal. Për këtë rast i jemi drejtuar me kërkesë Prokurorisë dhe aktualisht jemi në pritje të përgjigjes.

Ndryshe ka ndodhur me rastin nr.201400353, për ankesën e shtetasës E. L., nga Tirana, banuese në Itali, ku organi procedues ka zbatuar me korrektësi nenin 105 të Kodit të Procedurës Penale. Qytetarja i ka kërkuar Prokurorisë së Rrethit Gjirokastrë, vënien në dispozicion të akteve të fashikullit të hetimit nr.4036 të vitit 2013, për veprën penale të "Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor" parashikuar nga neni 290 të Kodit Penal, me pasojë vdekjen e babait të saj. Pas pezullimit të hetimit të procedimit penal, aktet ishin përcjellë në Drejtorinë e Policisë së Qarkut dhe më pas ato janë tërhequr nga Prokuroria duke iu vënë në dispozicion kopje të akteve të kërkuara, qytetares E. L.,.

Së dyti: Në mosshqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave apo memorieve me shkrim që palët paraqesin në procesin penal, sidomos gjatë fazës së hetimit paraprak.

Gjatë trajtimit të ankesave të qytetarëve, kemi konstatuar se kërkesat apo memoriet me shkrim, kryesisht të personave ndaj të cilëve organi procedues ka ngritur një akuzë, apo të avokatëve mbrojtës të caktuar prej tyre, në një pjesë të konsiderueshme nuk shqyrtohen dhe për rrjedhojë nuk respektohen kërkesat e pikës 2 të nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale, duke mos u shprehur me vendim brënda pesëmbëdhjetë ditëve, e për rrjedhojë pa njoftuar kërkuuesin.

I tillë është rasti i ankesës me nr. 201401325, i qytetarit M. H., akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 79/b, 25 e 22 të Kodit Penal, i cili është ankuar ndaj Prokurorisë për Krime të Rënda, pasi nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës së tij, paraqitur para prokurorit të çështjes.

Do të theksonim rëndësinë e përmbajtjes të neneve 105 dhe 110 të Kodit të Procedurës Penale, pasi nga ana e Prokurorit kërkesat e palëve duhet të merren, të shqyrtohen dhe pasi të vlerësohen, është detyrimi i organit procedues për të marrë vendim i cili mendojmë se duhet të jetë i arsyetuar, sidomos për rastet kur refuzohet kërkesa.

Nga mosveprimi i organit procedues për mosdhënie të akteve të procedimit penal në rastet e mësipërme kanë sjellë për pasojë interesat e ligjshëm të qytetarëve dhe konkretisht:

a.Për rastin e ankesës së shtetasit Xh.M., mosrregjistrimin e pasurisë së tij në ZVRPP

b.Për rastin e ankesës së shtetasit G. Gj., pamundësinë e kryerjes së veprimeve të qytetarit me mjetet që ka në pronësi, duke filluar me pengimin në kryerjen e aktiviteteve privat apo familjar; kontratën për shitjen e tyre ose daljen jashtë shtetit.

c. Për rastin e ankesës së shtetasit V. Q., në pushimin e çështjes apo zvarritje në proceset gjyqësore civile që lidhen domosdoshmërisht me marrjen e akteve të nevojshme .

Sa i përket, mosshqyrtimit të kërkesave apo memorieve të personave nën hetim apo përfaqësuesit të tyre, pasojat janë:

a.për organin procedues, pasi si rezultat i mosverifikimit të “pretendimeve” që paraqesin personat nën hetim mund të vijnë zvarritje të hetimit apo marrja e një vendimi përfundimtar të pabazuar.

b. deri në cënimin e një procesi të rregullt ligjor, neni 42/2 i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe neni 6 i KEDNJ.

Së treti: Në mosnjoftimin ose vonesa në njoftimin e palëve për vendimet përfundimtare të marra nga Prokuroria.

Në disa raste qytetarët janë ankuar ndaj Prokurorisë për arsye se prej saj nuk kanë marrë dijeni lidhur me mënyrën e zgjidhjes së kallëzimit penal, apo vendimit përfundimtar të marrë prej saj.

I tillë është rasti me nr.201401177, për ankesën e shtetases A. D., nga Tirana, e cila ankohej ndaj Prokurorisë, duke pretenduar se nuk kishte dijeni për mënyrën e zgjidhjes së kallëzimit penal për veprën penale të “Mashttrimit” , paraqitur nëmuajin Qershor 2013. Nga verifikimi i ankesës rezultoi se Prokuroria kishte informuar se kallëzimi i shtetases A. D., ishte rregjistruar me numerin 4963, për të cilin më datën 07.10.2013, kishte vendosur mosfillimin e procedimit penal. Njoftimi për vendimin e mosfillimit të procedimit penal ishte bërë kallëzueses nëpërmjet postës në rrugë zyrtare datë 11.11.2013.

Në rastin me nr.201400167, qytetarja I. N., nga Tirana, është ka ngritur pretendimin se Prokuroria nuk e ka njoftuar për mënyrën e zgjidhjes së kallëzimit penal rregjistruar me numerin 6810 të vitit 2013, për të cilin Prokuroria më datën 20.09.2013, kishte vendosur mosfillimin e procedimit penal.

Në rastin me nr.201400414, qytetari J. C., nga Elbasani, është ankuar ndaj Prokurorisë pasi sipas tij nuk e ka njoftuar mbi mënyrën e përfundimit të hetimit, për zbardhjen e së vërtetës së ngjarjes së datës 07.07.2004, që lidhet me humbjen e djalit të tij A. C.,. Prokuroria për këtë rast kishte filluar procedimin penal nr.361 të vitit 2004 dhe dy herë kishte vendosur pezullimin e hetimeve. Policia i ka dërguar Prokurorisë aktet e dosjes së pezulluar në vitin 2012, por nuk ishte bërë e mundur gjetja dhe administrimi i provave për zbardhjen e ngjarjes.

Qytetari V. Q., më datën 12.12.2014, ka paraqitur ankesë, në të cilën ka ngritur pretendimin se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk e ka njoftuar me vendimin përfundimtar pas kallëzimit penal të datës 13.11.2013, marrë nga Policia Gjyqësore e Sektorit Kundër Krimit Financiar të Dr.P.Q.Tiranë, kurse kjo e fundit i ka dërguar materialet organit procedues, Task Forcës. Ky rast i cili ka numerin 20140227, është marrë në shqyrtim dhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë i kemi dërguar shkresën “Kërkesë për informacion”.

Së katërti: Në kthimin me vonesë të përgjigjeve shkresave “Kërkesë për informacion” dhe Rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

Konstatohet jo vetëm mosrespektimin e afatit të kërkuar për kthimin e përgjigjeve për shkresat “Kërkesë për informacion”, e cila bie ndesh me

paragrafin e fundit të nenit 19 të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit" me ndryshimet përkatëse, por vonesat i kalojnë dhe afatet edhe mbi 1 muaj.

Sa i përket Rekomandimeve të Avokatit të Popullit, jo vetëm që nuk respektohet afati 30 ditor i parashikuar në nenin 22 të Ligjit "Për Avokatin e Popullit", për kthimin e përgjigjes nga Prokuroria, ose në raste të tjera përgjigja nuk përmban shpjegime të arsyetura për çështjen në fjalë apo veprimet dhe masat e marra për vënien në vënd të së drejtës që i është shkelur qytetarit.

Nga analiza e rasteve të mësipërme dhe të tjera të trajtuara në institucionin e Avokatit të Popullit arrijmë në disa përfundime dhe konkretisht:

1.Njoftimi i vendimeve të marra nga Prokurori për mënyrën e zgjidhjes së kallëzimit të qytetarëve apo përfundimit të hetimit të çështjes bëhet me vonesa dhe, jo menjëherë ashtu si parashikohet në diospozitat përkatëse siç është neni 291/2 i Kodit të Procedurës Penale.

Megjithë vështirësitë objektive sidomos në adresat e pasakta të vëndbanimit, apo lëvizjet demografike të qytetarëve, organi i Prokurorisë duhet të gjejë e shfrytëzojë të gjitha mundësitë për marrjen e masave me qëllim njoftimin apo dhënien e vendimeve përfundimtare palëve në procesin penal. Pse jo, të impenjohet për dhënien e tyre edhe kur qytetarët paraqiten në Institucionin e Prokurorisë.

2. Për rastet e pezullimit të hetimit, në përgjithësi Prokuroria nuk njofton apo nuk dërgon palëve vendimin përkatës, me arsyetimin se ky detyrim nuk parashikohet në nenin 326 të Kodit të Procedurës Penale.

Mendojmë se edhe për këtë rast, ashtu si dhe për vendimet e tjera që merr prokurori, palët duhet të njoftohen, pasi ata kanë të drejtën ligjore, për ta kundërshtuar apo ankimuar ato në gjykatë.

Ky detyrim rrjedh dhe për faktin, se palët duhet të njihen me veprimet e nevojshme të kryer nga organi procedues, kërkesë kjo e pikës 2 të nenit 326 të K.Pr.Penale. Në rrethana të tilla qytetarët, bazuar në pikën 5 të nenit 24 të K.Pr.P mund t'i drejtohen jo vetëm gjykatës, por edhe Prokurorit më të lartë, me kërkesë për të ndryshuar ose shfuqizuar vendimin e marrë nga Prokurori më i ulët.

Në praktikën e veprimtarisë hetimore të Prokurorisë, në raste të veçanta ndodh kur Prokurori mund të vendosë pushimin e akuzës ndaj personit nën hetim, dhe të pezullojë hetimin e çështjes penale. Për rrjedhojë palët duhet të njihen me të dy vendimet e marra nga Prokurori në një procedim penal të vetëm.

Jo në pak raste, për ngjarje kriminale që lidhen me humbjen apo zhdukjen e personave, siç është edhe rasti i ankesës së shtetasit J. C., qytetarët nuk janë njohur me vendimin e pezullimit të hetimit. Mendojmë se duke qënë persona të interesuar në procesin penal, ata duhet të njoftohen me vendimin e pezullimit të hetimeve, pasi duke marrë informacionin e nevojshëm kanë dhe detyrime të tjera ligjore si, ai që parashikohet në nenin 15 të Kodit Civil të Republikës të Shqipërisë, për t'ju drejtuar gjykatës me kërkesë, e mandej ajo të marrë vendim për shpalljen e zhdukur të personit.

Menduar t'ju bëjmë prezent problematikat e mësipërme duke kërkuar nga Prokuroria, respektimin e të drejtave të palëve në procesin penal, si të drejta kushtetuese dhe procedurale.

E drejta e informimit është një e drejtë themelore dhe e përgjithshme e cila parashikohet në nenin 23 pika 1 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

Ndërsa neni 20 i Kodit të Procedurës Administrative, parashikon të drejtën e çdokujt që me anë të një kërkesë të marrë informacion dhe çdo dokument nga çdo organizëm publik dhe administrata është e detyruar t'i japë informacionin apo dokumentin e kërkuara qytetarit sa më shpejt. E drejta e marrjes së kopjeve të akteve parashikohet dhe në nenin 105 të Kodit të Procedurës Penale. Realizimi i këtyre të drejtave bëhet i mundur nëpërmjet rritjes së përgjegjësisë për punën, duke zbatuar me rrigorozitet jo vetëm dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, aktet normative të Prokurorit të Përgjithshëm si dhe aktet ndërkombëtare të nxjerra për këtë qëllim.

Zgjidhja e shqetësimeve të qytetarëve, për rastin konkret palë në procesin penal, e obligon Prokurorinë dhe në respektimin e të drejtave të njeriut, që është dhe misioni i Institucionit të Avokatit të Popullit.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”,* si dhe nenin 21 gërma “b” të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” me ndryshimet përkatëse, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit.....paraqet rekomandime për vënien në vënd të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”.*

REKOMANDOHET

“Përmirësimi i punës me qëllim zbatimin korrekt nga Prokuroria i dispozitave procedurale për dhënin e akteve, shqyrtimin e vlerësimit e kërkesave apo memorieve me shkrim dhe njoftimin menjëherë të vendimeve përfundimtare, palëve në procesin penal”.

Bërjen e analizës për rastet e cituara më lart, dhe marrjen e masave ndaj personave përgjegjës, me qëllim që ato të mos përsëriten në të ardhmen.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij Rekomandimi, lutemi na vini në dijeni brënda afatit ligjor prej 30 ditësh, të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin Tuaj.

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI